



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

Nr. 757/11 prot

Tiranë, më 07/06/ 2017

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 104 date 07/06/ 2017

Për marrjen e masave për ndalimin e venies në përdorim për subjektet zgjedhore të mjeteve, fondeve dhe materialeve të ndryshme, prone e administratës publike, si dhe burimeve njëzore për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë

Bazuar në VKM nr. 473, datë 01.06.2017, Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhore për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2017

URDHËROJ:

1. Ndalimin e venies në përdorim për subjektet zgjedhore të mjeteve, fondeve dhe materialeve të ndryshme, prone e Institutit të Shëndetit Publik, si dhe burimeve njëzore për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë
2. Cdo departament të marrë masa për të garantuar mospërdorimin e:
 - a. Burimeve njëzore të institucionit në funksion të veprimtarisë së fushatës zgjedhore
 - b. Fondeve të institucionit për veprimtaritë e fushatës zgjedhore
 - c. Mjeteve dhe materialeve në inventar të institucionit për veprimtaritë e fushatës zgjedhore
 - d. Zhvillimin e fushatës zgjedhore në ambjentet e institucionit
 - e. Administratës në fushatë zgjedhore brenda orarit të punës.

Adresa: Rr. "A. Moisiu" Tirana, Albania, Tel. + 355 4 37 47 56 Fax. + 355 4 37 00 58. www.ishp.gov.al

3. Gjate periudhes se fushates zgjedhore, automjetet e institucionit si dhe karburanti i institucionit ndalohen te perdoren per veprimtari te fushates zgjedhore.
4. Cdo departament te depozitoje ne drejtori te dhenat per aktivitetet publike te programuara per muajin qershor dhe korrik ne lidhje me veprimtarine e institucionit, si dhe projektet e nisura prej 12- muajsh ne ushtrim te punes dhe te veprimtarise se institucionit.
5. Te mos iniciohet asnje procedure e re prokurimi public deri ne perfundimin e fushates zgjedhore, me perjashtim te rastit te procedurave urgjente dhe te domosdoshme per funksionimin e institucionit, per te cilat duhet te merret miratimi paraprak nga Ministri i Shendetesise.
6. Sektori i IT-se, te marre masa per publikimin ne faqen zyrtare te ISHP-se te ketyre aktiviteteve me qellim shmangien e keqperdorimit dhe keqinterpretimit te aktiviteteve te institucionit me fushaten elektorale.
7. Ngarkohen per ndjekjen dhe zbatimin e ketij urdhëri: N/Drejtori Teknik, N/Drejtori Ekonomik, Shefat e Departamenteve dhe Sektori i Burimeve Njerzore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI
ARJAN BREGU

